

VENDIM
Nr.170, datë 13.2.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA GRABIAN TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Grabian të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 4 (katër), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Grabian për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMULARI PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Mbeshtetur ne inventarizimin e pronave te vecanta te tipit Kulloa , Livadhe , Shkembore etj)

Institucioni i Pushtetit Qendror Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.
Komuna: Grabian

Nr	Nr.i INV Sipas VKM	Emertesa e Ekonomis Pyjore dhe kullosores (EPK)	Emertesa e Ngastres Vendendodhja (sipas emerteses popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Siperfaqe ha	Funksioni Per te cilin perdoreshi prona	Institucioni Enti me Pergjegjesit Administrative	Institucioni Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te Vecanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	69	Gradishte – Gjeneruke	shpati m. madh	23/a	pyll	23.6	prodhues	MMPAU	D.SH.P Lushnje	
	69	Gradishte – Gjeneruke	shpati m. madh	23/b	pyll	3	prodhues	MMPAU	D.SH.P Lushnje	
2	70	Gradishte – Gjeneruke	gryka e llozes	24/a	pyll	38.3	prodhues	MMPAU	D.SH.P Lushnje	
	70	Gradishte – Gjeneruke	gryka e llozes	24/b	bosh	2	prodhues	MMPAU	D.SH.P Lushnje	
	70	Gradishte – Gjeneruke	gryka e llozes	24/c	pyll	2	prodhues	MMPAU	D.SH.P Lushnje	
3	71	Gradishte – Gjeneruke	gorina e grabijanit	25/a	pyll	20	prodhues	MMPAU	D.SH.P Lushnje	
	71	Gradishte – Gjeneruke	gorina e grabijanit	25/b	bosh	0.5	prodhues	MMPAU	D.SH.P Lushnje	
4	72	Gradishte – Gjeneruke	gorina e plemres	26/a	pyll	7.2	prodhues	MMPAU	D.SH.P Lushnje	
	72	Gradishte – Gjeneruke	gorina e plemres	26/b	bosh	2	prodhues	MMPAU	D.SH.P Lushnje	

Njësia e Qeverisjes Vendore Grabian

Lidhja 1

[illegible]